

Burrat dhe Gratë në Shqipëri, 2017

Tiranë, më 09 Qershor 2017: Gratë në Shqipëri janë më të kualifikuara dhe janë më pak të paguara se burrat, sipas raportit “*Burra dhe Gra në Shqipëri, 2017*”. Hendeku gjinor në pagë është 6,3 % në favor të burrave kjo do të thotë se gratë paguhen mesatarisht 93,7 % të pagës së burrave. Pjesëmarrja e ulët në tregun e punës së grave dhe niveli i ulët në përgjithësi i pagave ndikojnë në një hendek gjinor më të ulët në krahasim me vendet e tjera. Burrat janë më pjesëmarrës në tregun e punës ndërsa gratë janë më të zëna me detyrat shtëpiake. Në grupmoshën 25-39 vjeç, përqindja e grave që ka përfunduar arsimin e lartë është rreth 27,0 % ndërsa për burrat është 19,0 %. Përqindja e përfaqësimit të grave në parlament është 24,0 % dhe përqindja e grave drejtuese në ndërmarrje është 27,0 %.

Punësimi

Burrat kanë një pjesëmarrje më të lartë në tregun e punës sesa gratë, respektivisht me 74,1 % dhe 59,3 %. Për 21,5 % të grave arsyeja e mospjesëmarrjes lidhet kryesisht me detyrimin për të përmbushur detyrat shtëpiake, ndërkohë burrat që nuk punojnë për këtë arsye janë vetëm 1 përqind. Shkalla e papunësisë për gratë e grup-moshës 15-64 vjeç është 14,6 % ndërsa për burrat është 16,4 %. Burrat janë të punësuar kryesisht në sektorët e ndërtimit, industrinë nxjerrëse, prodhimin e energjisë elektrike, ujit dhe gazit si dhe shërbimet e tregut (transport, tregti me shumicë dhe pakicë, etj.). Gratë dominojnë industritë përpunuese dhe shërbimet jo të tregut (administrata publike dhe shërbimet sociale).

Arsimi

Në të gjitha ciklet e arsimit parauniversitar djemtë kanë një pjesëmarrje më të lartë se vajzat, 53,0 %. Ky raport përmbysset në nivelin universitar ku vajzat përbëjnë 58,0 % të studentëve gjithsej. Në fund të vitit 2016, rezulton se 63,8 % e të diplomuarve janë vajza dhe 36,2 % janë djem. Të dhënat për nivelin arsimor tregojnë se mbi 65 vjeç vetëm 3,8 % e grave janë me arsim të lartë, ndërsa në grup-moshën 25-39 vjeç, kjo shifër është 27,2 %. Në arsimin bazë 9 vjeçar 72,8 % e mësuesëve janë gra dhe në arsimin e mesëm janë 65,0 %. Në arsimin universitar me titull profesor ka 39,9 % gra. Në arsimin universitar ka 60,0 % burra me titull professor dhe 58,0 % gra me titull doktor. Në pozicionet drejtuese të stafit universitar ka 42 dekanë burra dhe 15 dekanë gra si dhe 11 rektorë burra dhe vetëm 1 rektore grua.

Gratë në vendimarrje

Në fund të vitit 2016 niveli i përfaqësimit të grave në parlament është 24,0 %, kjo është përqindja më e lartë që prej vitit 2008, ndërkohë që kuota gjinore në kodin zgjedhor është 30,0 %. Përqindja e ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë është 26,8 %. Përfaqësim më të lartë të drejtimit të ndërmarrjeve gratë e kanë për ndërmarrjet me më pak se 10 punonjës, ndërsa në ndërmarrjet me mbi 20 punonjës burrat drejtues mbizotërojnë me 80,0 %. Gratë janë më shumë prezente si drejtuese në ndërmarrjet e prodhimit të shërbimeve, 33,3 % në krahasim me ndërmarrjet e prodhimit të të mirave, 11,7 %. Numri i grave kredimarrëse për vitin 2016 është rritur me 17,0 %, në krahasim me një vit më parë, ndërsa numri i burrave që marrin kredi është ulur me 28,0 %.

Popullsia

Popullsia banuese në Shqipëri më 1 Janar 2017 është e përbërë nga 50,5 % burra dhe 49,5 % gra. Raporti gjinor në lindje është për vitin 2016 është 1,07 në favor të djemve, që do të thotë se për çdo 107 djem lindin 100 vajza. Ky raport mbetet relativisht më i lartë se ai natyror i cili është në intervalin 1,04 - 1,06. Numri mesatar i fëmijëve për një grua në moshë riprodhuese është 1,5. Ky nivel është nën nivelin e zëvendësimit 2,1 që prej vitit 2002. Gratë jetojnë mesatarisht 3 vite më shumë se burrat. Jetëgjatësia mesatare në lindje llogaritet 77,0 vite për burrat dhe 80,1 vite për gratë. Mosha mesatare e martesës për gratë është 25,1 vjeç dhe për burrat 30,4 vjeç.

Statistikat juridike

Për vitin 2016, të dëmtuarit gra nga vepra penale “Dhuna në familje” janë 76,4 %, dhe “Krime në fushën e trafiqeve të paligjshme” janë 77,1 %. Numri i grave të dhunuara në raport me numrin e popullsisë së tyre për 10 mijë banorë, është më i lartë në qarkun e Durrësit, 30,6 % dhe Lezhës 25,2 %. Ndërsa qarku i Dibrës dhe i Kukësit janë qarqet me normën më të ulët të këtij fenomeni, përkatësisht 7,6 dhe 10,2 %.

Nga ana tjetër, të dëmtuarit burra nga vepra “Krime kundër personit” janë 91,6 % dhe “Krime ndaj pronës” janë 84,8 %.